

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI: RIPARIM DHE MIREMBAJTJE E LINJES DHE PAJISJEVE TE GAZRAVE MJEKESORE NE SPITALIN RAJONAL ELBASAN

Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): Shërbime Mirëmbajtje dhe Riparimi: 50000000-5; Shërbime të ndryshme për Riparim dhe Mirëmbajtje: 50800000-3

Fondi limit: 2,499,846 (dy milion e katërqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e dyzet e gjashtë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a. ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, **sipas Shtojcës 10.**

b. Sigurimin e Ofertës, **sipas Shtojcës 3;**

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të përcaktuara në pikën 1, Shtojca 9 të DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 “Kriteret e kualifikimit” të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2022-2023-2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të lotit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2/c të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe pikës 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe Rekomandimit të APP-së nr7998 date 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, dhe është vendosur me qëllim që AK të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % e vlerës së fondit limit të lotit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi,

dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3, 55 pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në dispozitat e sipërcituara.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është përcaktuar bazuar në legjislacionin e fushës, konkretisht, nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, duke shërbyer kështu si një garanci për AK, që ofertuesit zotërojnë kapacitete dhe eksperiencë për të zbatuar kontratën, me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie dhe në përmbushje të specifikimeve teknike.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë dhe të paraqesë certifikatë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, dhe të jetë e vlefshme, si më poshtë:

S H E N ISO 9001 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalente/ te barasvlefshme; Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Standarti ISO 9001 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë” – Ky standard është i nevojshëm pasi ndikon në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve, duke qenë se ky standart fokusohet në cilësinë e procesit të riparimit të sistemeve/ pajisjeve ngrohje/ftohje, rrjedhimisht siguron AK që ofertuesi do të përmbushë/realizojë shërbimet objekt prokurimi, sipas pritshmërive/specifikimeve teknike të kërkuara. Implementimi i këtij standarti ndihmon në optimizimin e burimeve dhe përmirësimin e efikasitetit të shërbimeve, duke ulur kostot dhe kohën e riparimit.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me licensë profesionale të vleshme, të lëshuar nga autoritetet kompetente shtetërore, për kategorinë:

- **NS 12-A (Impiante teknologjike, termike dhe te kondicionimit)**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe Ligjin nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, VKM nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret e procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencën profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

Duke vlerësuar që nëpërmjet NS12-A “Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit”, sistemet e ajrit të kompresuar, vakumit dhe oksigjenit mjekësor klasifikohen si **impiante teknologjike me presion**, të cilat kërkojnë ndërhyrje të specializuar dhe të certifikuar. Kjo licencë mbulon **instalimin, mirëmbajtjen dhe riparimin** e këtyre impianteve, duke garantuar sigurinë dhe funksionimin e tyre në mjediset spitalore.

Licenca dhe kategoria, e përcaktuar si kriter është në përputhje dhe lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës që do të prokurohet, fondin limit dhe cilësinë e shërbimit, që kërkohet të ofrohet nëpërmjet kësaj marrëveshje kuadër.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar stafin teknik, për realizimin e shërbimeve objekt prokurimi, sipas profileve të mëposhtme:

- a. 1 (një) Drejtues Teknik inxhinier mekanik, i përfshirë në licencën profesionale të ofertuesit
- b. 1 (një) teknik për sisteme gazrash mjekësorë.
- c. 1 (një) punonjës elektro – mekanikë/ elektrikist/ saldator, për mbulimin e shërbimit 24 orësh të gatishmërisë

Për punonjësin në pikën a, duhet të paraqitet:

- Diplomë përkatëse
- kontratë pune të vlefshme gjatë periudhës së vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër

Për punonjësin në pikën b dhe c duhet të paraqitet:

- kontratë pune të vlefshme gjatë periudhës së vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër
- dëshmi aftësie profesionale (të vlefshme), sipas Ligjit Nr.15/2017, “Mbi arsimin dhe formimin profesional”, i ndryshuar

Ky Kriter konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kriteri për punonjësit vendoset nga një analizë e specifikimeve teknike, grafikut të ekzekutimit të kontratës dhe specifikimeve teknike, termat e referencës, hartuar nga AK.

Drejtues Teknik nevojitet për organizimin, drejtimin, ndarjen dhe mbikëqyrjen e punëve, si dhe përgjigjet për zbatimin e të gjitha detyrave dhe fazave të shërbimit, në përputhje me specifikimet teknike, rregullat dhe standartet ligjore të zbatueshme në fuqi.

Për shkak të specifikave të sistemit të gazrave mjekësorë, të cilët përfshijnë impiante me presion, pajisje mekanike dhe elektrike, panele automatike, motorë, pompa vakumi dhe kompresorë industrialë, kërkohet prania e një strukture teknike të specializuar dhe të certifikuar, drejtuesi Teknik vlerësohet të jetë inxhinier mekanik, duke siguruar AK se mbikëqyrja e shërbimeve të mirëmbajtjes, ndërhyrjeve si dhe vlerësimi i kërkesave teknike të AK, verifikimi i cilësisë së shërbimeve do të jetë brenda standarteve të zbatueshme në fuqi. Duke qenë se objekti i prokurimit përmban edhe furnizim vendosjen e pjesëve të defektuara apo te nevojshme për t’u ndërruar/riparuar, inxhinieri mekanik është i aftë të vlerësojë përputhshmërinë e pjesës së re, analizon ndikimin në sistemin ekzistues. Ky inxhinier ka kompetencat e nevojshme për të marrë vendime për zgjidhjet teknike dhe për të mbajtur përgjegjësi profesionale, duke garantuar sigurinë, funksionalitetin e ndërhyrjeve që do të kryhen.

Specialistët e kërkuar janë vlerësuar të nevojshëm për arsye se:

- Drejtues Teknik (inxhinier mekanik), i përfshirë në licencën profesionale të ofertuesit, siguron mbikëqyrjen profesionale të proceseve, interpretimin teknik dhe garanton përputhshmërinë me standardet e impianteve me presion.
- Tekniku i gazrave mjekësorë është i domosdoshëm për ndërhyrjet praktike në instalime, panele, priza, linja bakri dhe pajisje të presionit të lartë, të cilat kërkojnë certifikim sipas ligjit për arsimin dhe formimin profesional. Garanton funksionimin të sigurt, të vazhdueshëm dhe të standardizuar të sistemeve të gazrave mjekësorë në spital.
- Punonjës elektro – mekanikë/ elektrikist/ saldator, për shkak të natyrës komplekse të sistemit të gazrave mjekësorë, i cili përfshin kompresorë, pompa vakumi, motorë elektrikë, panele automatike dhe pajisje me presion të lartë, është i nevojshëm një punonjës **elektro–mekanik / elektrikist / saldator**. Ky person siguron ndërhyrje të menjëhershme për riparimin e defekteve elektrike dhe mekanike, garanton funksionimin e pandërprerë të sistemit, dhe kryen saldimet dhe montimet e tubacioneve bakri dhe aksesorëve të tjerë sipas standardeve spitalore. Përveç kësaj, roli i tij mbulon **gatishmërinë 24-orëshe**, duke minimizuar çdo rrezik për ndërprerje të furnizimit me gazra mjekësorë dhe duke siguruar që shërbimet të realizohen brenda parametrave teknike dhe sigurisë së kërkuar nga ligji dhe standardet spitalore.

Stafi teknik i kërkuar siguron mbikëqyrje profesionale, ndërhyrje të specializuara dhe mbulim 24-orësh, duke garantuar funksionimin të sigurt, të vazhdueshëm dhe të standardizuar të sistemeve të gazrave mjekësorë. Ky kombinim kompetencash mundëson realizimin e

shërbimeve me efikasitet, përputhshmëri me standardet teknike dhe siguri për pacientët dhe stafin spitalor.

2.3.5 Operatori ekonomik, duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se të gjitha materialet që përdoren për riparime dhe furnizim vendosje, të shërbimit objekt prokurimi, do të jenë të çertifikuara (CE) ose (FDA).

Argumentimi: Kjo kërkesë vendoset në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i cili lejon Autoritetin Kontraktor të përcaktojë kritere të veçanta në varësi të objektit që prokurohet dhe që konsiderohen të nevojshme për realizimin me sukses të kontratës. Duke iu referuar specifikimeve teknike dhe termave të referencës, dhe duke qenë se objekti i prokurimit përfshin mirëmbajtjen, riparimin, furnizimin dhe vendosjen e pajisjeve dhe pjesëve të këmbimit të sistemeve të gazrave mjekësorë, ajrit të kompresuar dhe vakumit, kërkohet që të gjitha materialet dhe pajisjet të jenë të certifikuara CE ose FDA, të reja dhe të furnizohen nga prodhues ose distributorë të autorizuar.

Përmes kësaj deklarate, synohet të garantohet që operatori ekonomik fitues do të kryejë shërbimin në përputhje me specifikimet teknike, duke siguruar funksionimin të sigurt dhe të vazhdueshëm të impianteve. Certifikatat CE dhe FDA shërbejnë si vërtetim i cilësisë, sigurisë dhe përputhshmërisë së produkteve me standardet ndërkombëtare, duke garantuar që furnizimi dhe vendosja e pajisjeve nuk paraqesin rrezik për pacientët dhe stafin mjekësor dhe janë në përputhje me standardet ligjore dhe teknike të zbatueshme. Kjo masë është thelbësore për sigurinë, funksionalitetin dhe cilësinë e shërbimit, duke përfshirë monitorimin e vazhdueshëm, mirëmbajtjen, riparimin dhe zëvendësimin e pajisjeve dhe pjesëve të këmbimit të sistemeve të gazrave mjekësorë, në përputhje me kërkesat e Autoritetit Kontraktor.

2.3.6 Operatori ekonomik, duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se të gjitha materialet që do të përdoren për riparime dhe furnizim vendosje, për realizimin e shërbimit objekt prokurimi, dhe që i nënshtrohen kërkesave të ligjit nr. 89/2014 “Për pajisjet mjekësore” i ndryshuar, do të jenë të regjistruara me certifikatë regjistrimi pranë “Agjensisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (AKBPM)” sipas parashikimeve të këtij ligji.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim” pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”....”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”. Kërkesa për deklarimin e materialeve dhe pajisjeve që do të përdoren në riparime, furnizim dhe vendosje ka për qëllim të garantojë që të gjitha pjesët dhe pajisjet janë të sigurt, të kontrolluara dhe të cilësisë së lartë. Kjo siguron funksionimin të pandërprerë dhe të besueshëm të sistemeve, shmang rreziqet për pacientët dhe

stafin, dhe garanton që çdo ndërhyrje të kryhet me materialet e duhura dhe të aprovuar për përdorim spitalor.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike/termat e referencës dhe përlogaritja e fondit limit janë përgatitur/hartuar/përcjellë nga Autoriteti Kontraktor “Spitalit Rajonal Elbasan”, për nevojat e së cilit, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, në cilësinë e Organit Qendror Blerës kryen procedurën e prokurimit, në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-në nr.531 datë 7.9.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqëndruara” Sh.a për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të Varësise”, i ndryshuar.

Specifikimet teknike/termat e referencës janë pjesë e pandashme e DST.